

Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 68 paragrafi 5 të Rregullores gjyqësore dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më **07.12.2021** miratoi konkluzion mbi çështjet juridike të Gjykatave të apelit Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip për harmonizimin e praktikës gjyqësore:

K O N K L U Z I O N

Në procedurë për kundërvajtje kur një herë është abroguar aktgjykimi i shkallës së parë dhe duhet të ndryshohet nga dënimi me lirim në atë dënues, me konstatimin e gjendjes së ndryshme faktike nga ajo të cilën e ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë është e obliguar të caktojë seancë, në të cilën do t'i ftojë palët dhe të gjithë pjesëmarrësit tjerë në procedurë.

Sektori i veprave penale